



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

UDHËZUES PËR RAPORTIMIN E KOMPANIVE TË LICENCUARA

Tetor 2008

Adresa: Rr. Ferat Dragaj 68, Prishtinë
Tel: (038) 249 165 ext. 101; E-mail: info@wwro-ks.org

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
1.1. QËLLIMI I KËTIJ UDHËZUESI.....	3
1.2. KONTAKTIMI I ZRRUM.....	3
2. OBLIGIMET RAPORTUESE TË KOMPANIVE TË LICENCUARA	4
2.1. OBLIGIMET RAPORTUESE TË KOMPANIVE	4
2.1.(A). PLANI I BIZNESIT	4
2.1.(B) RAPORTET MUJORE.....	5
2.1.(C). RAPORTI VJETOR.....	5
2.1(D) PASQYRAT FINANCIARE	5
2.1.(E) DORËZIMI I INFORMACIONEVE QË KËRKOHEN KOHËPASKOHE NGA ZRRUM	6
2.2. AUDITIMI/INSPEKTIMI I TË DHËNAVE TË RAPORTUARA	6
3. RËNDËSIA E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË KOMPANIVE PËR PROCESIN E RAPORTIMIT..	7
4. PËRPUNIMI DHE VLERËSIMI I TË DHËNAVE TË RAPORTUARA DHE RAPORTIMI I ZRRUM PËR PEFORMANCËN E KOMPANIVE TË LICENCUARA	7
5. MASAT NË RAST TË MOSRESPEKTIMIT TË OBLIGIMEVE RAPORTUESE.....	8
SHTOJCAT	9
SHTOJCA 1: PËRMBAJTJA E PLANIT TË BIZNESIT.....	10
SHTOJCA 2: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT.....	16
SHTOJCA 3: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE.....	19
SHTOJCA 4: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË (IBER-LEPENC)	21
SHTOJCA 5: RAPORTI VJETOR	22
SHTOJCA 6: RAPORTI MUJOR - KOMPANIA PËR MENAGJIMIN E DEPONIMIT TË MBETURINAVE (KLMC).....	23

1. Hyrje

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM) është autoritet i pavarur rregullator i themeluar me ligj në bazë të Kushtetutës së Kosovës. Përgjegjësitë e ZRRUM janë përcaktuar me Rregulloren 2004/49 të 26 nëntor 2004 dhe me amendamentimin e bërë me Ligjin Nr. 03/L-086 të datës 13 qershor 2008.

Një prej përgjegjësave kryesore të ZRRUM është monitorimi i performancës së Kompanive të licencuara. Kjo për faktin se përmes monitorimit të punës së Kompanive ZRRUM duhet të sigurohet se Kompanitë janë duke i përmbushë obligimet e tyre të përcaktuara me Ligj si dhe me licencë të shërbimit

Në anën tjetër **Kompanitë e licencuara kanë përgjegjësi që të raportojnë tek ZRRUM** për të demonstruar se ato i përmbushin kushtet dhe obligimet që dalin nga licenca e shërbimit. Obligimet raportuese të kompanive të licencuara që ofrojnë shërbimet e: (i) ujësjellësit dhe kanalizimit, (ii) furnizimit të ujit me shumicë, (iii) grumbullimit të mbeturinave, dhe (iv) deponimit të mbeturinave rrjedhin nga kuadri ligjor që e ka përcaktuar kornizën rregullatore për rregullimin ekonomik të këtyre kompanive (Rregullorja 2004/49 dhe Ligji nr. 03/L-086) dhe këto obligime më hollësisht janë përcaktuar me aktet nënligjore që ka nxjerrë ZRRUM (Rregullat) si dhe me licencën e shërbimit të cilën ZRRUM e ka lëshuar për kompanitë përkatëse që ofrojnë shërbimet e sipër përmendura.

1.1. Qëllimi i Këtij Udhëzuesi

Ky udhëzues ka për qëllim që të ofrojë një përmbledhje të obligimeve raportuese të kompanive të licencuara si dhe t'iu lehtësojë atyre përmbushjen e këtij obligimi. Në veçanti ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë shpjegime për çështjet si vijon:

- Si duhet të organizohen Kompanitë e Licencuara për të qenë në gjendje t'iu përmbahen obligimeve raportuese;
- Si ti kuptojnë obligimet që dalin nga legjislacioni sekundar; dhe
- Cilat masa ZRRUM mund ti ndërmer në rast të mospajtueshmërisë së Kompanive të licencuara me obligimet e tyre raportuese.

1.2. Kontaktimi i ZRRUM

Kompanitë e licencuara gjatë orarit të rregullt të punës nëse kanë pyetje apo dëshirojnë të sqarojnë ndonjë çështje lidhur me raportim mund të kontaktojnë personin përgjegjës për këtë çështje në ZRRUM:

Zt. Qamil Musa

Adresa: Rr. Ferat Dragaj 68, Prishtinë

Tel: (038) 249 165 ext. 121

E-mail: gamil.musa@wwro-ks.org

2. Obligimet Raportuese të Kompanive të Licencuara

ZRRUM duhet të posedojë informacion të duhur dhe me kohë lidhur me aktivitetet e Kompanive të licencuara në mënyrë që të jetë në gjendje të ushtrojë rolin dhe përegjegjësitë e veta si rregullator ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Për këtë arsye është e domosdoshme që kompanitë të dorëzojnë raportet e tyre me të dhënat financiare, operative, dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, në mënyrë që ZRRUM të zhvillojë një proces cilësor rregullator.

Formati dhe frekuenca e raporteve që duhet ti dorëzohen ZRRUM janë përcaktuar me aktet nënligjore (Rregullat e ZRRUM) dhe përbëjnë një prej obligimeve kryesore të kompanive të licencuara që dalin nga licenca e shërbimit.

2.1. Obligimet Raportuese të Kompanive

Obligimet kryesore raportuese të kompanive të licencuara ndaj ZRRUM janë si vijon:

- (a) Plani i Biznesit
- (b) Raportet Mujore
- (c) Raporti Vjetor
- (d) Pasqyrat Financiare
- (e) Dorëzimi i Informacioneve tjera që Kërkohen Kohëpaskohe nga ZRRUM

Përpos këtyre raporteve Kompania është e obliguar të raportojë te ZRRUM në afat prej 10 ditëve të punës për:

- Çfarëdo ndryshimi material në cilindo fakt ose informacion të dorëzuar me aplikacionin për licencë të shërbimit;
- Çfarëdo faktet apo rethana kanë ndodhur që Kompania nuk është në gjendje të përmbush kushtet e parapara me licencë të shërbimit;

2.1.(a). Plani i Biznesit

Planet e Biznesit të Kompanitë e licencuara janë dokument kyç për përcaktimin e tarifave si dhe për mbikqyrjen e përmbushjes së caqeve dhe objektivave të tyre të planifikuara. Me këto plane përcaktohen strategjia dhe pikëpamjet e Kompanive të licencuara lidhur me financimin e nevojshëm për të ofruar shërbimet e licencuara në pajtim me standardet minimale të shërbimit si dhe caqet e përcaktuara për ngritjen e efijencës së kompanive.

Udhëzimet dhe formati sipas të cilit duhet të përpilohen planet e biznesit u janë dorëzuar Kompanive të licencuara. Shqyrtimi planeve të biznesit është një aspekt i rëndësishëm i punës së ZRRUM. Prandaj, Kompanitë e licencuara duhet që draftin e planit të biznesit t'ia dorëzojnë ZRRUM për shqyrtim në mënyrë që ZRRUM të këtë mundësi të vlerësojë dhe të sfidojë caqet dhe objektivat e planifikuara të kompanive.

Plani i Biznesit mund të dërgohet në **kopje elektronike (në formatin pdf) apo në formë të kopjes së printuar** me letër përcjellëse në adresë të ZRRUM me postë ose personalisht.

2.1.(b) Raportet Mujore

ZRRUM ka hartuar një sistem të raportimit që përmban të dhëna financiare, operative, dhe të shërbimeve të konsumatorëve të cilat Kompanitë e licencuara duhet ti raportojnë te ZRRUM. Ky sistem i raportimit që njihet si OFCR/ROFK dorëzohet çdo muaj nga Kompanitë e licencuara tek ZRRUM në formë elektronike dhe shërben për përcjelljen e trendeve sa i përket operimit të kompanive.

Formati dhe udhëzimet sqaruese (Manuali) lidhur me këtë sistem të raportimit ZRRUM i ka dorëzuar tek të gjitha Kompanitë e licencuara dhe ato janë të njoftuara në hollësi për mënyrën dhe formën e përgatitjes dhe dorëzimit të raporteve mujore. Për çdo përditësim apo modifikim të këtij sistemi të raportimit ZRRUM do të njoftojë me kohë dhe në mënyrë të duhur Kompanitë e licencuara.

Këto raporte duhet të dërgohen deri më datë 20 të muajit vijues të muajit për të cilin raportohet, në formë elektronike te personi kontaktues i ZRRUM (qamil.musa@wwro-ks.org).

2.1.(c) Raporti Vjetor

Raporti Vjetor për punën e Kompanive të licencuara paraqet plotësimin e Raporteve Mujore me raportimin e disa të dhënave shtesë që kanë të bëjnë me:

- (i) informata bazë të cilat nuk ka arsye të raportohen në baza mujore (si gjatësia e rrejtit të ujësjellësit, gjatësia e rrejtit të kanalizimit, popullata e shërbyer etj.), dhe
- (ii) informatat lidhur me investimet kapitale dhe asetet.

Formatin dhe udhëzimet sqaruese lidhur me Raportin Vjetor ZRRUM iu ka dorëzuar Kompanive të licencuara

Këto raporte duhet të dërgohen deri më 31 Mars të vitit vijues prej vitit për të cilin raportohet, në formë elektronike te personi kontaktues i ZRRUM (qamil.musa@wwro-ks.org).

2.1(d) Pasqyrat Financiare

Kompanitë janë të obliguara me i dorëzua Pasqyrat Financiare në ZRRUM, si dokumente të përfunduara. Nga Pasqyrat Financiare të vitit të përmbyllur fiskal, kompanitë obligohen të dorëzojnë:

- (i) Pasqyrën e Bilancit,
- (ii) Pasqyrën e të Ardhurave,

- (iii) Pasqyrën e Rrjedhjes së Parës së Gatshme, dhe
- (iv) Pasqyrën e Analizës Financiare të Kompanisë të dalë nga afarizmi i vitit të shkuar.

Të gjitha pasqyrat financiare duhet të jenë të nënshkruara dhe të vërtetuara me vulën e kompanisë dhe si të tilla dorëzohen në ZRRUM deri me 31 mars të vitit vijues.

Kompanitë janë të obliguara ti auditojnë Pasqyrat e Financiare me auditorë të pavarur i cili zgjedhet me tender të hapur dhe konkurrues dhe të njëjtat pas auditimit duhet të dërgohen në ZRRUM më së voni deri me 31 gusht të vitit vijues.

Përveq kësaj, Kompanitë janë të obliguara ti dërgojnë ZRRUM Pasqyrat Financiare 3-mujore të pa-audituar deri më 15 të muajit pasues pas periudhës 3-mujore për të cilën raportohet (më datën 15 të muajve: prill, korrik, tetor dhe janar).

2.1.(e) Dorëzimi i Informacioneve që Kërkohen Kohëpaskohe nga ZRRUM

Kohëpaskohe, ZRRUM kërkon informacione që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të veprimtarisë së Kompanive të licencuara, të cilat mund të mos jenë pjesë e raportimeve të rregullta. Në këto kërkesa do të specifikohen saktë lloji dhe natyra e informacioneve të kërkuara si dhe data kur duhet të dorëzohen.

Kompanitë e licencuara janë të obliguara të iu përgjigjen kërkesave të përcaktuara dhe të dërgojnë informacionet e kërkuara në formën dhe afatin e përcaktuar në kërkesën e ZRRUM.

2.2. Auditimi/Inspektimi i të Dhënave të Raportuara

Të dhënat e raportuara duhet të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, të sakta dhe të bazuara në sistemin informativ të kompanisë. Me qëllim të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara, ZRRUM bën auditimin/inspektimin e tyre në baza vjetore dhe në raste të jashtëzakonshme sipas nevojës.

ZRRUM do të njoftojë me kohë dhe në formë të shkruar Kompanitë e licencuara për procesin e auditimit. Ky njoftim në mes tjerash, do të përfshijë:

- Metodën e auditimit
- Çështjet kyçe që adresohen me auditim
- Kalendarin e propozuar të auditimit
- Personelin e involvuar në auditim – ekipin e auditimit

Auditimi përfshinë gjithashtu edhe verifikimin se a i ka Kompania të aprovuara dhe të zbatueshme procedurat lidhur me aspektet e ndryshme të veprimtarisë së vet në pajtim me rekomandimet e ZRRUM-it dhe obligimet që dalin nga licenca e shërbimit..

3. Rëndësia e Organizimit të Brendshëm të Kompanive për Procesin e Raportimit

Organizimi i brendshëm i Kompanive të licencuara është me rëndësi kyçe për dorëzimin me kohë të raporteve në pajtim me obligimet ligjore të tyre dhe kërkesat raportuese të ZRRUM.

Personi kryesor përgjegjës për përmbushjen e obligimeve të Kompanisë ndaj ZRRUM (rrjedhimisht edhe për dorëzim të raporteve) është Drejtori Ekzekutiv i Kompanisë. Meqë është evidente se përpilimi i raporteve është një aktivitet kompleks që kërkon të dhëna nga departamente të ndryshme atëherë rekomandojmë që Kompania e licencuar të emëroj një Zyrtar për Punët Rregullatore i cili do të ketë përgjegjësi për menaxhimin e procesit të raportimit të Kompanisë ndaj ZRRUM dhe për koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me procesin rregullator në përgjithësi.

Zyrtari i Raportimit ka përgjegjësi:

- Të mbajë kontakte të rregullta me ZRRUM, në mënyrë që ti sqarojë të gjitha çështjet dhe problemet që lidhen me raportimin me kohë dhe në cilësinë e kërkuar;
- Të marrë pjesë në sesionet konsultuese dhe në punëtoritë e ZRRUM lidhur me çështjet e raportimit dhe çështjet e tjera lidhur me procesin rregullator;
- Të koordinojë me stafin tjetër të Kompanisë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me grumbullimin e informatave që duhet të raportohen;
- Të përgatisë dhe përpilojë raportet të cilat do ti dorëzohen ZRRUM të nënshkruara dhe të vërtetuara nga Drejtori Ekzekutiv.

Iu rekomandohet Kompanive të licencuara që të bashkëpunojnë ngushtë me ZRRUM në të gjitha format dhe aktivitetet që organizon ZRRUM me qëllim të lehtësimit dhe ngritjes së cilësisë së raportimit. Në këtë plan ZRRUM do të organizojë: takime konsultative, punëtori, inspektime dhe forma tjera të bashkëpunimit ku do të trajtohen ndryshimet dhe avancimet lidhur me aspekte të raportimit.

4. Përpunimi dhe Vlerësimi i të Dhënave të Raportuara dhe Raportimi i ZRRUM për Peformancën e Kompanive të Licencuara

Në bazë të të dhënave të raportuara nga Kompanitë e licencuara dhe pas verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre përmes procesit të auditimit, ZRRUM do të përgatisë dhe publikojë një raport vjetor të performancës për kompanitë e licencuara. Ky raport do të pasqyrojë performancën e sektorit në përgjithësi dhe të kompanive të licencuara veç e veç. Poashtu në këtë raport vjetor të performancës ZRRUM do të vlerësojë dhe rangojë kompanitë në bazë të treguesve kyq të performancës.

Ky raport vjetor i performancës ka dy qëllime kryesore: (i) ngritjen e transparencës për punën e Kompanive të licencuara si dhe (ii) stimulimin e konkurrencës ndërmjet kompanive.

5. Masat në Rast të Mosrespektimit të Obligimeve Raportuese

ZRRUM ka autoritet ligjor për të ndërmarr masa ndëshkuese ndaj Ofruesve të Shërbimit të cilët nuk i përmbahen kërkesave raportuese të ZRRUM si dhe obligimeve që burojnë nga legjislacioni pozitiv dhe Licenca e Shërbimit. Këto masa kosnsistojnë prej gjobitjes deri te revokimi i licencës së shërbimit.

31 Tetor 2008



.....
Afrim Lajçi
Drejtor
Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PËRMBAJTJA E PLANIT TË BIZNESIT

Plani i Biznesit të kompanive për periudhën 3-vjeçare duhet që në minimum të përmbajë:

- (a) Një përshkrim të përmbledhur të Kompanisë
- (b) Një pasqyrë të performancës së Kompanisë në të kaluarën
- (c) Objektivat strategjik të Kompanisë dhe rezultatet e matshme;
- (d) Aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave strategjik;
- (e) Planin Operativ dhe të Shërbimeve ndaj Konsumatorëve
- (f) Planin e Menaxhimit të Aseteve dhe Investimeve
- (g) Planin Financiar

(a) Përshkrimi i Përmbledhur i Kompanisë

Në këtë kapitull duhet të jipet një pasqyrë në formë të përmbledhur lidhur me Kompaninë. Këtu do të duhej të jipen informacione si: veprimtaria e Kompanisë, zona e shërbimit, popullata e shërbyer, numri i konsumatorëve, struktura organizative e Kompanisë, Misioni i Kompanisë etj.

(b) Performanca e Kompanisë në të Kaluarën

Në këtë pjesë të Planit të Biznesit duhet të jipet një përshkrim i performancës së Kompanisë në vitin(et) paraprake sa i përket parametrave operativ, financiar dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

(c) Objektivat Strategjik të Kompanisë dhe Rezultatet e Matshme

Strategjia duhet të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve, dhe të jetë e ndërlidhur me kartën e konsumatorëve dhe obligimet tjera publike, si dhe të ofrojë një pasqyrë sa i përket çështjeve kryesore që i trajton Plani i Biznesit siq janë:

- Plani i Operimit dhe e Shërbimeve ndaj Konsumatorëve
- Plani i Menaxhimit të Aseteve, dhe
- Plani Financiar

Objektivat strategjik duhet të vendosen në formë të caqeve të matshme, p.sh. shkalla e arkëtimit të ngritet nga x% në y% në vitin e parë, nga y% në p% në vitin e dytë etj., së bashku me përshkrimin e hollësishëm se si kompania planifikon të arrijë këto përmirësime.

(d) Aktivitetet e Nevojshme për arritjen e Objektivave Strategjik

Plani i Biznesit të kompanisë duhet të ofrojë hollësi se si kompania planifikon të arrijë:

- Përmirësimin e shkallës së arkëtimit;
- Përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve;
- Përmirësimin e furnizimit me ujë;
 - Reduktimin e humbjeve të ujit (Ujit të Pa-arkëtuar);
 - Reduktimin e humbjeve fizike;
 - Reduktimin e humbjeve komerciale;
 - Përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ujësjellësit (orë në ditë, presioni, ndërprejet e planifikuara dhe të paplanifikuara etj.);
 - Përmirësimin e kualitetit të ujit;
 - Ngritjen e shkallës së mbulueshmërisë;
 - Përmirësimin e nivelit të shërbimeve të kanalizimit;
- Përmirësimin e nivelit të shërbimeve të kanalizimit;
 - Ngritjen e mbulueshmërisë me shërbime/Zgjerimin e zonës së shërbimit;
 - Reduktimin e bllokimeve të kanalizimit dhe përmbytjeve nga kanalizimi;
 - Përmbushjen e standardeve të trajtimit të ujërave të zeza, etj.

(e) Plani Operativ dhe i Shërbimeve ndaj Konsumatorëve

Plani Operativ

Duhet të përmbajë një përshkrim të aktiviteteve dhe si secili prej aktiviteteve i kontribuon arritjes së objektivave strategjik të kompanisë. Aktivitetet operative të cilat i kontribuojnë arritjes së objektivave strategjik mund të përfshijnë:

- Përmirësimin e monitorimit të kualitetit të ujit;
- Përmirësimin e matjes së prodhimit dhe matjes së zonave të caktuara (DMA) për kontrollimin e humbjeve;
- Përmirësimin e menaxhimit të ndërprerjeve të ujit;
- Punësimin e personelit shtesë për arritjen e objektivave strategjik, si p.sh. përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve (hapja e qendrës së re të konsumatorëve ose moduli i kompjuterizuar për konsumator% në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të kompanisë etj.)
- Përmirësimin e regjimit të mirëmbajtjes (aktive dhe reaktive);
- Aktivitetet për reduktimin e humbjeve (të cilat nuk kërkojnë investime kapitale), si p.sh. testimet e prurjes së natës, dëgjimi i rrjedhjeve etj.
- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Komunikimi dhe relacionet me konsumatorët.

Plani i Shërbimeve ndaj Konsumatorëve

Kjo pjesë e Planit të Biznesit duhet të identifikojë se si Kompania planifikon të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatorëve dhe të kuantifikojë benefitet për konsumatorët.

Fushat që do të duhej adresuar në planin e shërbimeve ndaj konsumatorëve do të duhej të përfshinin:

- Azhurnimin e Kartës së Konsumatorëve në një format të broshurës e cila do të hartohet në një gjuhë të kuptueshme për konsumatorët dhe në të cilën precizohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të Kompanisë dhe konsumatorëve. Kjo broshurë do tu shpërndahej të gjithë konsumatorëve;
- Adresimi i çështjes së pagesës së faturave për kategorinë e rasteve sociale;
- Hartimin e procedurave për njoftimin e konsumatorëve në rastet e emergjencave (kur cënohet cilësia e ujit apo sasia e ujit);
- Përmirësimi i formatit të faturës;
- Hartimin e procedurave për trajtimin e ankesave/kërkesave të konsumatorëve;
- Instalimin e modulit (software-it) për menaxhimin e ankesave të konsumatorëve.
- Përcaktimi i saktë i nivelit aktual të shërbimeve në zonat e caktuara (kontinuiteti i shërbimit, presioni, ndërprerjet e planifikuara, problemet me kualitetin e ujit të pijes etj.).

(f) **Plani i Menaxhimit të Aseteve dhe Investimeve**

Plani i Menaxhimit të Aseteve si pjesë e Planit të Biznesit duhet të përfshijë aspektet vijuese:

- **Mirëmbajtja kapitale:** Shpenzimet e nevojshme për ti mbajtur asetet në një gjendje operacionale në mënyrë që të zbuten efektet e shkatërrimit dhe vjetërsisë;
- **Investimet Kapitale për Kërkesat e Rritura:** Shpenzimet e nevojshme për ti marrë parasysh dhe akomoduar kërkesat e rritura . Ky aspekt shpesh referohet si “mbajtja e balancit ndërmjet furnizimit dhe kërkesës”;
- **Investimet Kapitale për Obligimet e Reja:** Shpenzimet e nevojshme për ti përmbushur obligimet që dalin nga legjislacioni i ri ose kërkesat e konsumatorëve;
- **Investimet Kapitale për Përmirësim:** Investimet kapitale për të kompenzuar mungesën e investimeve në të kaluarën ose për të riparuar mangësitë evidente në ofrimin e shërbimeve.

Plani i Menaxhimit të Aseteve duhet ti përfshijë seksionet si vijon:

i. Çështjet strategjike dhe të planifikimit

Në këtë seksion duhet të ofrohet një deklaratë e qartë sa i përket objektivave të përgjithshme që do të arrihen me investimet e propozuara në plan. Kjo duhet të përfshijë:

- Një shqyrtim kritik të obligimeve të kompanisë – performancën dhe ofrimin e shërbimeve
- Identifikimin e rreziqeve, të tanishme dhe të ardhshme sa i përket ofrimit të shërbimeve;
- Peridhën planifikuese për të cilën është bërë analiza.

ii. Qasja e Kompanisë sa i përket Planifikimit të Menaxhimit të Aseteve

Qasja e kompanisë duhet të përmbajë:

Menaxhimi

Duhet të ofrohet një përshkrim për procesin e planifikimit të menaxhimit të asetëve të kompanisë, duke përfshirë diagramet/grafikonet e procesit me theks të veçantë në elementet kyçe të procesit prej grumbullimit të të dhënave deri te vendimi për intervenime; mënyrën e monitorimit dhe kontrollit për sigurimin e rezultateve të pritura dhe efektivitetit.

Proceset

Duhet të shpjegohet se si qasja e përgjithshme e planifikimit të menaxhimit të asetëve është pjesë e Punës së përditshme sikurse edhe operimet tjera të zakonshme. Duhet të bëhet një përmbledhje e qasjes së adoptuar për tu siguruar se i tërë planifikimi i menaxhimit të asetëve është i integruar dhe siguron se janë planifikuar intervenimet optimale.

Sistemet

Duhet të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur sistemi që posedon kompania për mbledhjen dhe shfrytëzimin e të dhënave për: shërbimet, performancën e asetëve, aktivitetet e intervenimit, dhe kostot. Poashtu duhet të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur sistemi që posedon kompania për monitorimin dhe kontrollin e 'shërbyeshmërisë' (të demonstron lidhja në mes të të dhënave, mirëmbajtjes së asetëve dhe planifikimit të asetëve), si dhe sistemi që posedon kompania për marrjen dhe shfrytëzimin e të dhënave për kostot njësi.

iii. Arësytimi

Të gjitha skemat e investimeve duhet të klasifikohen sipas grupimeve (mirëmbajtje kapitale, kërkesat e rritura, obligimet e reja që dalin nga legjislacioni, dhe përmirësimet).

Shfrytëzimi i të dhënave

Për secilën skemë ose kategori të skemave, kompania duhet të shpjegojë se si janë mbledhur të dhënat që mbështesin planifikimin e menaxhimit të asetëve, duke dhënë sqarime për secilin rast lidhur me cilësinë e të dhënave, dhe për verifikimin dhe validitetin e procesit:

- Observimet për shërbimin dhe performancën e asteve
- Të dhënat për aktivitetet riparuese dhe ndikimin e tyre në shërbyeshmërinë
- Të dhënat për kostot dhe ndërlidhjen e tyre me aktivitetet riparuese (kostot operative dhe kapitale)

Analizat e bëra

- Duhet të përshkruhet qasja analitike në bazë të cilës mbështeten parashikimet e shpenzimeve, duke i prezantuar të gjitha mangësitë e të dhënave ose mangësitë e analizave të bëra, me ç`rast është bërë një gjykim inxhinierik.
- Duhet të përshkruhet tërësia e zgjidhjeve alternative që janë marrë në konsiderim për zbutjen e mangësive dhe të jipen arësyet pse janë aprovuar apo refuzuar zgjidhjet e caktuara.

Rezultatet

Për secilën skemë (projekt) duhet të jipet një deklaratë që deklaron përmirësimin e pritur sa i përket shërbimit nga implementimi. Kjo duhet të shprehet në formë të matshme (të kuantifikuar), dhe ku është e mundshme të deklarohet numri i konsumatorëve që përfitojnë nga përmirësimi i shërbimeve dhe të kuantifikohet ai përfitim.

Përshkrimi i skemave (projekteve), kostove, dhe implemtimi

Duhet që të jipet:

- Përshkrimi teknik i secilës skemë (projekt)
- Paralogaritja e kostove për secilën skemë duke përfshi bazën në çka është mbështetur paralogaritja
- Planin dinamik – kalendarin e implementimit

iv. Përcaktimi i prioriteteve (prioretizimi)

Duhet të rangohen të gjitha skemat (projektet) sipas prioriteteve në kuptim të përmirësimit të shërbimeve dhe zbutjes së rreziqeve. Të mbështetet ky rangim me shpjegime të duhura duke sqaruar çfarëdo parashikimi të kostove/benfitëve.

v. Zbatimi

Duhet të ofrohen hollësi se si Kompania planifikon ti zbatojë skemat (projektet) e identifikuar, në kuptim të vëllimit të punës përgjatë tërë peridhës së planifikuar si dhe relacionet ndërmjet skemave (projekteve) të zbatuara në mënyrë interne apo eksterne.

Duhet poashtu të jipet një përmbledhje e skemave të propozuara të grupuara sipas: Mirëmbajtjes kapitale, kërkesave të rritura, obligimeve të reja ligjore, dhe përmirësimeve.

(g) Plani Financiar

Qëllim kryesor i Planit Financiar është që të bëjë matjen dhe të krahasojë efikasitetin financiar, si atë operative poashtu edhe atë kapitale. Prandaj është me rëndësi që informacionet financiare të raportuara nga kompanitë të përmbajnë të njëjtat definicione, metoda të raportimit dhe kategori të shpenzimeve.

Në planin financiar si pjesë e Planit të Biznesit kompanitë Kompania duhet të propozojë tarifën e shërbimit të cilat konsiderohen të nevojshme për financimin e aktiviteteve të tyre të propozuara ashtu siq janë përcaktuar në planin e tyre, duke ndjekur metodologjinë tarifore të ZRRUM-it. Kjo do të iu mundësojë kompanive që të përgatisin një plan të kompletuar financiar i cili përmban projeksionet e hollësishme të të hyrave dhe të shpenzimeve.

Plani financiar duhet t'iu demonstrojë palëve të interesit se biznesi i pëgjithshëm është koherent dhe i përshtatshëm, dhe të i ndërlidh kostot me benefitet: p.sh. një investim në zonën matëse (DMA) duhet të shihet se çon kah zvogëlimi i humbjeve të ujit, ngritja e numrit të konsumatorëve dhe ngritja e vlerës së faturimit. kohet në mënyre të hollësishme.

Plani financiar duhet të bazohet në pritjet e kompanisë lidhur me të hyrat, shpenzimet, rrjedhjen e parasë ("cash flow") dhe duhet të përfshijë deklaratat financiare në bazë të cilave performanca e kompanisë mund të monitorohet dhe të matet në baza vjetore nga ZRRUM.

Deklaratë financiare lidhur me kostot historike që duhet të përfshihen në planin financiar të kompanisë duhet të përmbajnë:

- Pasqyrat vjetore të bilancit;
- Burimet vjetore dhe aplikimin e fondeve/ deklaratat e rrjedhjes së parasë së gatshme ("cash flow");
- Deklaratat vjetore të të hyrave të planifikuara.

Përpos deklaratave financiare të kostove historike, kompanitë duhet të dorëzojnë deklaratat financiare rregullatore të cilat përmbajnë:

- Pasqyrat rregullatore vjetore të bilancit në të cilat jepet përshkrim për performancën financiare të planifikuar, duke përfshi një analizë të Vlerës Rregullatore të Kapitalit (VRRK);
- Deklaratat vjetore të të hyrave rregullatore të planifikuara.

Përpos kësaj, Plani Financiar duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar lidhur me performancën financiare të planifikuar, duke përfshirë edhe analizën e rreziqeve për rezultatet e planifikuara.

SHTOJCA 2: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

TË DHËNAT OPERATIVE, FINANCIARE, INSTITUCIONALE, KUALITETIT TË SHËRBIMEVE DHE SHËRBIMIT ME KONSUMATORË OPERATIONAL, FINANCIAL, INSTITUTIONAL, SERVICE QUALITY AND CUSTOMER SERVICE DATA

No.	ID	Data	Të dhënat	Unit/Njesia	Dec-08	Jan-09	Feb-09	Mar-09	Apr-09	May-09	Jun-09	Jul-09	Aug-09	Sep-09	Oct-09	Nov-09	Dec-09
1	D 001	Water Production	Uji i Prodhuar	m ³													
2	D 002	Water Supply Invoiced	Uji i Faturuar	m ³													
3	D002.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	m ³													
4	D002.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	m ³													
5	D002.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	m ³													
6	D 003	Registered Customers	Konsumatorët e Regjistruar	numër													
7	D 003.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	numër													
8	D 003.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	numër													
9	D 003.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	numër													
10	D 003.4	Vulnerable Customers	Konsumatorët e Cenueshëm	numër													
11	D 003.5	Vulnerable Customers - Indigent	Konsumatorët e Cenueshëm -	numër													
12	D 003.6	Vulnerable Customers - Physician	Konsumatorët e Cenueshëm me	numër													
13	D 004	No. of Bills Issued	Nr. i Faturave të Lëshuara	numër													
14	D 005	No. of Customers Billed by Meter	Numri i Konsumatorëve që Faturohen	numër													
15	D 006	Water Supply Invoiced to Metered	Uji i Faturuar për Konsumatorët me	m ³													
16	D 006.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	m ³													
17	D 006.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	m ³													
18	D 006.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	m ³													
19	D 007	Total Billing	Faturimi Total	€													
20	D 007.1	Billing for Water services	Faturimi për Shërbimin e Ujit	€													
21	D 007.1.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	€													
22	D 007.1.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	€													
23	D 007.1.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	€													
24	D 007.2	Billing for Wastewater Services	Faturimi për Shërbimin e Kanalizimit	€													
25	D 007.2.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	€													
26	D 007.2.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	€													
27	D 007.2.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	€													
28	D 007.3	Billing for Fixed Tariff	Faturimi për Tarifën Fikse	€													
29	D 008	Collection	Arkëtimi	€													
30	D 008.1	Residential Customers	Konsumatorët Shtëpiak	€													
31	D 008.2	Commercial-Industrial Customers	Konsumatorët Komercial-Industrial	€													

32	D 008.3	Institutional Customers	Konsumatorët Institucional	€															
33	D 009	Other Operating Income	Të Hyra të Tjera Operative	€															
34	D 010	Total Operating Costs before	Total Shpenzimet Operative pa	€															
35	D 010.1	Direct Operating Costs for Water	Shpenzimet Operative Direkte për	€															
36	D 010.1.1	Purchased Bulk Water (Untreated)	Uji i Blerë me Shumicë (i Patrajtuar)	€															
37	D 010.1.2	Salaries	Pagat	€															
38	D 010.1.3	Maintenance	Mirëmbajtja	€															
39	D 010.1.4	Energy	Energjia	€															
40	D 010.1.5	Fuel	Derivatet	€															
41	D 010.1.6	Chemicals	Kemikalet	€															
42	D 010.2	Direct Operating Costs for	Shpenzimet Operative Direkte për	€															
43	D 010.2.1	Salaries	Pagat	€															
44	D 010.2.2	Maintenance	Mirëmbajtja	€															
45	D 010.2.3	Energy	Energjia	€															
46	D 010.2.4	Fuel	Derivatet	€															
47	D 010.2.5	Direct Material	Materiali Harxhues	€															
48	D 010.3	Common Expenses	Shpenzimet e Përbashkëta	€															
49	D 011	Non-operating Income	Të Hyrat Jo-operative	€															
50	D 012	Non-operating Costs	Shpenzimet Jo-operative	€															
51	D 013	Write-offs towards Debtors	Shlyerja e Borxheve ndaj	€															
52	D 014	Write-offs by Creditors	Shlyerja e Obligimeve nga Kreditorët	€															
53	D 015	Cash in Hand & Bank	Paratë e Gatshme në Arkë dhe në	€															
54	D 016	Stock	Stoqet	€															
55	D 017	Accounts Receivables (from bills)	Llogaritë e Arkëtueshme (nga faturat)	€															
56	D 018	Other Accounts Receivables	Llogaritë Tjera të Arkëtueshme	€															
57	D 019	Accounts Payables (Creditors)	Llogaritë e Pagueshme (kreditore)	€															
58	D 020	No. of Employees	Numri i Punëtorëve	numër															
59	D 021	Technical Complaints for Water and	Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit	numër															
60	D 022	Technical Complaints Responded in	Ankesat Teknike të Shqyrtuara me	numër															
61	D 023	Commercial Complaints for Water	Ankesat Komerciale për Shërbimet e	numër															
62	D 024	Commercial Complaints Responded	Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në	numër															
63	D 025	Commercial Complaints Resolved in	Ankesat Komerciale të Zgjidhura me	numër															

64	D 026	Water Interruptions	Ndërprerjet e Ujit	numër															
65	D 027	Average Water Interruptions	Ndërprerjet Mesatare të Ujit	h															
66	D 028	Water Interruptions Notified in	Ndërprerjet e Ujit të Lajmëruara	numër															
67	D 029	No. of Water Quality Tests Performed	Nr. i Testeve të Realizuara të	numër															
68	D 030	No. of Water Quality Tests Non-	Nr. i Testeve të Realizuara të Ujit që	numër															
69	D 031	Service Contracts Entered with	Kontratat e Shërbimit të Lidhura me	numër															
70	D 032	No. of Applications for Service	Nr. i Aplikacioneve për Kycje të	numër															
71	D 033	No. of Applications for Service	Nr. i Aplikacioneve për Kycje të	numër															
72	D 034	Service Connections Executed in Time	Kycjet e Shërbimit të Instaluar me	numër															
73	D 035	Individual Disconnections	Nr. i Shkycjeve Individuale	numër															
74	D 036	Disconnections for Non-payment	Shkycjet për Mos-pagesë	numër															
75	D 037	Disconnections of Abandoned	Shkycjet e Objekteve të Boshatisura	numër															
76	D 038	Disconnections for Other Reasons	Shkycjet për Shkaqe Tjera (të	numër															
77	D 039	No. of Re-connections	Nr. i Ri-kycjeve	numër															
78	D 040	Applications for Collective	Nr. i Aplikacioneve për Shkycje	numër															
79	D 041	Approved Collective Disconnections	Nr. i Shkycjeve Kolektive të	numër															
80	D 042	Executed Collective Disconnections	Nr. i Shkycjeve Kolektive të	numër															
81	D 043	No. of Collective Re-connections	Numri i Ri-kycjeve Kolektive	numër															
82	D 044	No. of Illegal Re-connections	Nr. i Ri-kycjeve të Paligjshme	numër															
83	D 045	Payment Agreements	Marrëveshjet për Pagesë/Ri-	numër															
84	D 046	Disconnection Notices	Njoftimet për Shkycje	numër															
85	D 047	No. of Wastewater Manholes	Nr. i Përgjithshëm i Pusetave të	numër															
86	D 048	Inspected Wastewater Manholes	Nr. i Pusetave të Kanalizimit të	numër															
87	D 049	Non-functional Wastewater Manholes	Nr. i Pusetave Jofunkionale të	numër															
88	D 050	No. of Repaired Wastewater	Nr. i Pusetave të Kanalizimit të	numër															
89	D 051	The Length of Cleaned Wastewater	Gjatësia e Rrjetit të Kanalizimit të	km															
90	D052	Number of Blockages in Wastewater	Numri i Bllokimeve në Kanalizim	numër															
91	D053	Number of Damages in Water	Numri i Prishjeve në Gypat Kryesor të	numër															
92	D054	Number of Repaired Damages in	Numri i Prishjeve të Riparuara në	numër															
93	D055	Number of Damages in Water	Numri i Prishjeve në Gypat e Kycjes	numër															
94	D056	Number of Repaired Damages in	Numri i Prishjeve të Riparuara në	numër															

SHTOJCA 3: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

Përshkrimi i zërave	Njesia	Dec-08	Jan-09	Feb-09	Mar-09	Apr-09	May-09	Jun-09	Jul-09	Aug-09	Sep-09	Oct-09	Nov-09	Dec-09
MBULIMI ME SHËRBIME														
Tërë popullata në zonën e shërbimit	n													
Popullata e shërbyer	n													
Konsumatorët e regjistruar	n													
Amvisërit	n													
Biznese & Industri	n													
Institucionet	n													
Faturat e lëshuara	n													
Amvisërit	n													
Biznese & Industri	n													
Institucionet	n													
TË DHËNAT FINANCIARE														
Faturimi	€													
Amvisërit	€													
Biznese & Industri	€													
Institucionet	€													
Arkëtimi	€													
Amvisërit	€													
Biznese & Industri	€													
Institucionet	€													
Të hyra të tjera operative	€													
Të hyrat jo operative	€													
Shpenzimet operative pa amortizim	€													
Pagat	€													
Derivatet	€													
Taksat e deponimit për KLMC	€													
Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	€													
Shpenzimet Tjera	€													
Shpenzimet jo operative	€													
Llogaritë e arkëtueshme	€													

Logaritë tjera të arkëtueshme	€																		
Logaritë e pagueshme	€																		
Paratë e gatshme në arkë dhe në bankë	€																		
Stoqet	€																		
Shlyerja e borxheve ndaj borxhlinjëve(konsumatorëve)	€																		
Shlyerja e obligimeve nga kreditorët (furnitorët)	€																		
TË DHËNAT OPERATIVE																			
Totali i mbeturinave të grumbulluara	t																		
Totali i mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara	t																		
Totali i mbeturinave të deponuara në deponitë e pa licencuara	t																		
Numri i turneve për ditë	n																		
Nr. i kamionëve 3-boshtorë të regjistruar (në dispozicion)	n																		
Nr. i kamionëve 2-boshtorë të regjistruar (në dispozicion)	n																		
Nr. i kamionëve ngarkues(skip) të regjistruar (në dispozicion)	n																		
Nr. i traktorëve të regjistruar (në dispozicion)	n																		
TË DHËNAT MBI STAFIN																			
Numri total i punëtorëve	n																		
Të punësuarit në aktivitetin primarë	n																		
Të punësuarit të tjerë	n																		
TË DHËNAT E RELACIONEVE ME KONSUMATORË																			
Numri i ankesave teknike	n																		
Numri i ankesave teknike të shqyrtuara me kohë	n																		
Numri i ankesave komerciale	n																		
Numri i ankesave komerciale të shqyrtuara në kohë	n																		
Numri i ankesave komerciale të zgjidhura me kohë	n																		
Kontratat e shërbimit të lidhura me konsumatorët	n																		

SHTOJCA 4: RAPORTI MUJOR - KOMPANITË E FURNIZIMIT TË UJIT ME SHUMICË (Iber-Lepenci)

No.	ID	Të dhënat	Njesia	Dec-08	Dec-09
1	D 001	Uji i paperpunuar shitur KRU Ujesjellesi Regjional	m ³		
2	D 002	Uji i paperpunuar shitur KRU Prishtina (Drenas)	m ³		
3	D 003	Faturimi per KRU Ujesjellesi Regjional	€		
4	D 004	Faturimi per KRU Prishtina (Drenas)	€		
5	D 005	Arketimi	€		
6	D 006	Arketimi per KRU Ujesjellesi Regjional	€		
7	D 007	Arketimi per KRU Prishtina (Drenas)	€		
8	D 008	Shpenzimet operative pa amortizim	€		
9	D 009	Numri i punëtorëve ne njesine e ujit te shitur ujesjellesave	n		
		Te dhenat teknike			
		Te dhenat financiare			

SHTOJCA 5: RAPORTI VJETOR

TË DHËNAT OPERATIVE, FINANCIARE, KUALITETIT TË SHËRBIMEVE DHE SHËRBIMIT ME KONSUMATORË						
OPERATIONAL, FINANCIAL, SERVICE QUALITY AND CUSTOMER SERVICE DATA						
No.	ID	Data	Të dhënat	Njësia	Të dhënat për vitin 2008	Burimi i informacionit
1	DV 001	Total Population	Total Popullsia	numër		
2	DV 002	Population Provided with Water Services	Popullsia e mbuluar me Shërbimet e Ujësllësit	numër		
3	DV 003	Population Provided with Wastewater Services	Popullsia e mbuluar me Shërbimet e Kanalizimit	numër		
4	DV 004	Length of Water Network	Gjatësia e Rrjetit të Ujësllësit	km		
5	DV 005	Replaced Length of Water Network	Gjatësia e Zëvendësuar e Rrjetit të Ujësllësit	km		
6	DV 006	Length of Wastewater Network	Gjatësia e Rrjetit të Kanalizimit	km		
7	DV 007	Replaced Length of Wastewater Network	Gjatësia e Zëvendësuar e Rrjetit të Kanalizimit	km		
8	DV 008	Total Amount of Capital Investments	Shuma Totale e Investimeve Kapitale	€		
9	DV 008.1	Capital Investments for Water Services	Investimet Kapitale për Shërbimin e Ujit	€		
10	DV 008.1.1	Capital Investments in Infrastructure	Investimet Kapitale në Infrastrukturë	€		
11	DV 008.1.2	Capital Investments in Non-Infrastructure	Investimet Kapitale në Jo-infrastrukturë	€		
12	DV 008.2	Capital Investment for Wastewater Services	Investimet Kapitale për Shërbimin e Kanalizimit	€		
13	DV 008.2.1	Capital Investments in Infrastructure	Investimet Kapitale në Infrastrukturë	€		
14	DV 008.2.2	Capital Investments in Non-Infrastructure	Investimet Kapitale në Jo-infrastrukturë	€		
15	DV 009	Company Individual Costs for Capital Investments	Shpenzimet Vetjake për Realizimin e Investimeve Kapitale	€		
16	DV 010	Loans for Capital Investments	Huatë për Realizimin e Investimeve Kapitale	€		
17	DV 011	Donations for Capital Investments	Donacionet për Realizimin e Investimeve Kapitale	€		

SHTOJCA 6: RAPORTI MUJOR - KOMPANIA PËR MENAGJIMIN E DEPONIMIT TË MBETURINAVE(KLMC)

No.	ID	Pershkrimi i zerave	Njesia	Dec-07	Jan-08	Feb-08	Mar-08	Apr-08	May-08	Jun-08	Jul-08	Aug-08	Sep-08	Oct-08	Nov-08	Dec-08
		TE DHENAT OPEARTIVE DHE FINANCIARE PER DEPONINE E PRISHTINES														
1	D 001	Faturimi	€													
2	D 002	Faturimi per kompanite e mbeturinave	€													
3	D 003	Faturimi per klientet tjere	€													
4	D 004	Arketimi	€													
5	D 005	Arketimi per kompanite e mbeturinave	€													
6	D 006	Arketimi per klientet tjere	€													
7	D 007	Shpenzimet operative pa amortizim	€													
8	D 008	Mbeturinat e hedhura	t													
		TE DHENAT OPEARTIVE DHE FINANCIARE PER DEPONINE E PRIZRENTIT														
9	D 009	Faturimi	€													
10	D 010	Faturimi per kompanite e mbeturinave	€													
11	D 011	Faturimi per klientet tjere	€													
12	D 012	Arketimi	€													
13	D 013	Arketimi per kompanite e mbeturinave	€													
14	D 014	Arketimi per klientet tjere	€													
15	D 015	Shpenzimet operative pa amortizim	€													
16	D 016	Mbeturinat e hedhura	t													
		TE DHENAT OPEARTIVE DHE FINANCIARE PER DEPONINE E GJILANTIT														
17	D 017	Faturimi	€													
18	D 018	Faturimi per kompanite e mbeturinave	€													
19	D 019	Faturimi per klientet tjere	€													
20	D 020	Arketimi	€													
21	D 021	Arketimi per kompanite e mbeturinave	€													
22	D 022	Arketimi per klientet tjere	€													
23	D 023	Shpenzimet operative pa amortizim	€													
24	D 024	Mbeturinat e hedhura	t													

TE DHENAT OPEARTIVE DHE FINANCIARE PER DEPONINE E PODUJEVES														
25	D 025	Faturimi	€											
26	D 026	Faturimi per kompanite e mbeturinave	€											
27	D 027	Faturimi per klientet tjere	€											
28	D 028	Arketimi	€											
29	D 029	Arketimi per kompanite e mbeturinave	€											
30	D 030	Arketimi per klientet tjere	€											
31	D 031	Shpenzimet operative pa amortizim	€											
32	D 032	Mbeturinat e hedhura	t											
TE DHENAT OPEARTIVE DHE FINANCIARE PER S. TRANSFERUES TE FERIZAJIT														
33	D 033	Faturimi	€											
34	D 034	Faturimi per kompanite e mbeturinave	€											
35	D 035	Faturimi per klientet tjere	€											
36	D 036	Arketimi	€											
37	D 037	Arketimi per kompanite e mbeturinave	€											
38	D 038	Arketimi per klientet tjere	€											
39	D 039	Shpenzimet operative pa amortizim	€											
40	D 040	Mbeturinat e hedhura	t											
TE DHENAT TJERA FINANCIARE PER KLMC														
41	D 041	Shpenzimet operative pa amortizim (pa kostot e kontratave)	€											
42	D 042	Shpenzimet jo operative	€											
43	D 043	Te hyrat jo operative	€											
44	D 044	Shlyerja e borxheve ndaj borxhlinjeve(konsumatoreve)	€											
45	D 045	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët (furnitorët)	€											
46	D 046	Paratë e gatshme në arke dhe në banka	€											
47	D 047	Llogaritë e arketueshme	€											
48	D 048	Llogaritë e pagueshme	t											